



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0042202-2 dt. 28.06.2024
Mitrovicë 24

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Propozim – Vendimin Nr. 01-020/04-0042202/24, dt. 25.06.2024, të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M


(Për formimin e Grupit Punues për Mbajtjen e Dëgjimeve Buxhetore 2025-2027 në Komunën e Mitrovicës së Jugut)

1. **Formohet** Grupi Punues për Mbajtjen e Dëgjimeve Buxhetore 2025-2027 në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Zenel Çitaku – Koordinator, Udhëheqës për Buxhet dhe Financa/ZKF, DBF;
 - 1.2. Igballe Islami – anëtare, Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
 - 1.3. Mentor Ujkani – anëtar, Zyrtar për Buxhet dhe Financa, DBF;
 - 1.4. Donjeta Maxhuni – anëtare, Zyrtare për Buxhet dhe Financa, DBF;
 - 1.5. Besa Veseli – anëtare, Njësia për të Drejtat e Njeriut (Zyrtare për Barazi Gjinore).
2. Grupi Punues në bashkëpunim me DEMOS-in janë përgjegjës për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore për planifikim të buxhetit për vitet 2025-2027 në Komunën e Mitrovicës së Jugut, duke dëgjuar kërkesat e qytetarëve dhe duke përfshirë rekomandimet e tyre në planifikimin e buxhetit brenda kornizave ligjore.
3. Grupi Punues gjatë dëgjimeve buxhetore bazë për punën e tyre do të kenë dispozitat ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
4. Pas përfundimit të dëgjimeve buxhetore Grupi Punues harton Raport me Shkrim me rekomandimet e tij për një planifikim të mirëfilltë të buxhetit, dhe i njëjti i dorëzohet Kryetarit të Komunës.
5. Mandati i Grupit Punues të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi përfundon pas përfundimit të detyrave të përcaktuara në këtë Vendim.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës




Bedri HAMZA

Shtojcë:

Propozim-vendimi i DBF Nr. 01-020/04-0042202/24, dt. 25.06.2024

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyres Ligjore
- 1x1 Zyres për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Anëtarëve Grupit Punues
- 1x1 Arkivit

